



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 293/9 Prot

Tiranë, më 13.11.2020

V E N D I M

Nr.145, datë 13.11.2020

“Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë së aktit nr. 94 (1629 prot.) datë 17.04.2020 të Kryetarit të Bashkisë Tropojë, për dhënie mase disiplinore ndaj nëpunësës ** dhe masat për përmirësimin e gjendjes”***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të verifikimit të informacionit të marrë nga një kërkesë e paraqitur prej nëpunësës *****,

Vërej se:

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është paraqitur një kërkesë e regjistruar me nr. 293 prot., datë 27.04.2020, nga nëpunësja ***** në të cilën janë parashtruar pretendimet e saj për paligjshmëri në një procedim administrativ për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”, me aktin administrativ nr. 94 (1629 prot.) datë 17.04.2020, të Kryetarit të Bashkisë Tropojë.

Nga përmbajtja e dokumentacionit të administruar, konstatohet se punonjësja ***** është nëpunëse civile, në pozicionin “Specialist për shpenzime arke dhe magazine, në Sektorin e Buxhetit dhe Financës”, në Bashkinë Tropojë, prandaj paraprakisht,

vlerësohet se shqyrtimi i kërkesës për verifikimin e ligjshmërisë së kësaj procedure disiplinore përfshihet në juridiksionin dhe kompetencën e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit që pasqyron veprimet administrative që janë kryer gjatë kësaj ecurie disiplinore, ka rezultuar sa më poshtë:

Institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit me anë të shkresës nr. 1457/7 prot., datë 27.07.2019 me lëndë: *“Dërgohet Raporti përfundimtar i Auditimit dhe Rekomandimet”* ka dërguar materialin përfundimtar të auditimit, ku në paragrafin **D** të tij, përshkruan rekomandimet për masat disiplinore, të propozuara për punonjësit që pretendohet se kanë kryer ose lejuar shkelje gjatë punës. Ndër të tjera është lënë rekomandim që ndaj punonjësës ***** *“Specialiste për shpenzime arke dhe magazine, në Sektorin e Buxhetit dhe Financës”*, në Bashkinë Tropojë, ka rekomanduar masën disiplinore *“Vërejtje”*, për shkelje të kryera prej saj, gjatë periudhës së kontrolluar, 01.01.2016-31.12.2018.

Në zbatim të kësaj detyre, duke qenë se masa disiplinore e propozuar për nëpunësen ***** , ishte *“Vërejtje”*, Përgjegjësi i Zyrës së Financës, në Drejtorinë Ekonomike të Bashkisë Tropojë, me cilësinë e eprorit të drejtpërdrejtë të nëpunësës ***** , me aktin nr. 787/59 prot. datë 31.07.2019, ka vendosur fillimin e ecurisë disiplinore dhe njoftimin për këtë fakt juridik të nëpunësit të proceduar.

Në këtë akt, në zbatim të pikës 7, të nenit 59, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, është caktuar edhe data për dëgjimin e pretendimeve të nëpunësit të proceduar, pavarësisht se ai, pretendimet e tij i kishte paraqitur një herë para audituesve të KLSH, në formë observacioni.

Brenda afatit të lënë nga eprori direkt, në dt. 05.08.2019 nëpunësi i proceduar, ka paraqitur me shkrim pretendimet e tij për mungesën e përgjegjësisë disiplinore, për shkeljet e evidentuara nga grupi i auditimit të KLSH.

Në përfundim, pasi ka administruar e vlerësuar edhe një herë provat shkresore dhe pretendimet e nëpunësës ***** , nga ana e eprorit direkt, në mungesë të përgjegjësisë disiplinore, është marrë vendim për ndërprerjen e ecurisë disiplinore të nisur ndaj nëpunësës në fjalë, konfirmuar kjo me aktin nr. 76 (787/61 prot.) datë 05.08.2019 të Kryetarit të Bashkisë *“Për ndërprerjen e hetimit disiplinor të ***** ”*.

Më pas, në kuadër të verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të dhëna, grupi i auditimit të KLSH, me shkresën nr. 1082/23 dt. 26.03.2020, ka përsëritur kërkesën, për marrjen e

masave organizative e administrative, sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit, dërguar më parë me shkresën 1475/7 dt. 27.07.2019.

Mbi këtë bazë, Kryetari i Bashkisë, me Urdhrin nr. 94 (1629 prot.) datë 17.04.2020, ka marrë masën disiplinore “Vërejtje”, të parashikuar në pikën a), të nenit 58, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Duke analizuar dhe vlerësuar ligjshmërinë e aktit aktit nr. 94 (1629 prot.) datë 17.04.2020, për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”, arrihet në përfundimin se jemi përpara një akti të paligjshëm, sipas pikës “dh” të nenit 109, të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”.

Ky akt vlerësohet si i marrë në kundërshtim me ligjin, për shkak se rekomandimi i dhënë në raportin përfundimtar të auditimit, për marrje mase disiplinore për nëpunësen *****, ishte marrë më parë në shqyrtim, në procedurën administrative të përfunduar me aktin nr. 76 (787/61 prot.) datë 05.08.2019 të Kryetarit të Bashkisë Tropojë, me të cilin është vendosur ndërprerja e hetimit disiplinor ndaj këtij nëpunësi.

Ky është një akt i ligjshëm, i marrë në ushtrim të rregullt të diskrecionit nga ana e eprorit direkt, pasi është respektuar procedura administrative për trajtimin e një ecurie disiplinore, përcaktuar në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, dhe vendimin nr. 115 dt. 05.04.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”.

Sipas pikës 6, të nenit 60, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, për çdo shkelje disiplinore merret vetëm një masë disiplinore. Në një kuptim më të zgjeruar të këtij përcaktimi, duhet thënë që për shqyrtimin e një shkelje disiplinore mund të zhvillohet vetëm një procedurë administrative, e cila në përfundim të saj, sipas pikës 17, të Vendimit nr. 115, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil”, të ndryshuar përmbyllet me një vendim për marrjen e masës disiplinore ose për ndërprerjen e ecurisë disiplinore.

Në rastin konkret, eprori direkt, në kompetencë të të cilit është shqyrtimi i ecurisë disiplinore për dhënien e masës “Vërejtje”, me aktin nr. 76 (787/61 prot.) datë 05.08.2019, ka vendosur ndërprerjen e ecurisë disiplinore.

Ky është një akt i ligjshëm i cili duhet të mbahej parasysht nga ana e drejtuesit aktual të bashkisë. Në bazë të pikës 1, të nenit 116, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave

Administrative i RSH”, një akt i ligjshëm mund të shfuqizohet vetëm kur kjo është e dosmosdoshme për të parandaluar apo eliminuar një dëmtim serioz të jetës dhe shëndetit të njerëzve apo sigurisë publike, rrethana këto që nuk kanë asnjë lidhje me rastin konkret. Në të njëjtën kohë, duhet theksuar se nxjerrja e aktit *nr. 94 (1629 prot.) datë 17.04.2020*, të Kryetarit të Bashkisë Tropojë, për dhënien e masës disiplinore “*Vërejtje*” ndaj nëpunëses *****”, nuk është diktuar nga ndonjë rrethanë e re, e cila nuk ishte mbajtur parasysh në zhvillimin e ecurisë disiplinore të mëparshme.

Nisur nga gjithë sa më sipër arrihet në përfundimin që urdhri *nr. 94 (1629 prot.) datë 17.04.2020*, të Kryetarit të Bashkisë Tropojë, për dhënien e masës disiplinore “*Vërejtje*” ndaj nëpunëses *****”, është një akt i paligjshëm, i cili në bazë të pikës dh), të nenit 109, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”, përbën ushtrim të diskrecionit në mënyrë jo të ligjshme. Ky akt, në bazë të pikës 1, të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”, duhet të anulohet nga vetë organi publik që e ka nxjerrë, me një akt të ri me shkrim, sipas pikës 3, të dispozitës në fjalë.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; bazuar në nenet 108, 110, 111 e 113 të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, si dhe në nenet 16, 34 dhe 35, të Rregullores, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të kërkoj nga ana e organit publik, Kryetari i Bashkisë Tropojë, të anulojë si të paligjshëm aktin administrativ *nr. 94 (1629 prot.) datë 17.04.2020*, të Kryetarit të Bashkisë Tropojë, për dhënien e masës disiplinore “*Vërejtje*” ndaj nëpunëses *****.
2. Njësia e Burimeve Njerëzore e Bashkisë Tropojë, të krijojë të gjitha kushtet e të ndjekë ecurinë e procesit administrativ, për zbatimin e detyrës së mësipërme.
3. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 10 ditë, nga marrja dijeni për këtë vendim.
4. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse është e detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.

5. Në rast të mos respektimit të këtij vendimi, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve, që nuk kanë kryer detyrimet e lëna në këtë vendim dhe në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
6. Të njoftohet për këtë vendim Bashkia Tropojë, Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe nëpunësja
*****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha